



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI

KONCEPTI

**I ARSIMIMIT DHE TRAJNIMIT INDIVIDUAL TË PERSONELIT TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Miratuar me Urdhër të Ministrit të Mbrojtjes

Nr.1083, datë 30.05.2017

Tiranë , më 30.05.2017

KONCEPTI

I ARSIMIMIT DHE TRAJNIMIT INDIVIDUAL TË PERSONELIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

1. HYRJE

Rritja e profesionalizmit, ndërveprimit dhe operacionalitetit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH), vijimi i transformimit, modernizimit, përmbushja e angazhimeve në kuadër të Aleancës, zbatimi i dokumenteve strategjike, rritja e gatishmërisë dhe zhvillimi i kapaciteteve për garantimin e sigurisë dhe përballimin e të gjithë skenarëve të kërcënimeve, kërkon një qasje të re në zhvillimin dhe konsolidimin e sistemit arsimor dhe trajnimit individual të personelit, për ta bërë atë sa më cilësor e fleksibël, në funksion të zhvillimit të vetë Forcave të Armatosura dhe të shoqërisë.

Arsimimi duhet të zhvillohet në mënyrë të tillë që t'i paraprijë transformimit të Forcave të Armatosura, duke përditësuar metodologjinë, programet mësimore e doktrinat ushtarake, hartuar dhe rishikuar procedurat standarde, për të normëzuar e unifikuar proceset dhe për të siguruar ndërveprueshmërinë me aleatët, me qëllim që t'u përgjigjet nevojave kombëtare, realiteteve dhe mundësive të reja në kushtet e një mjedisi të ri të sigurisë dhe të jetë i përputhshëm me sistemin e arsimit kombëtar dhe shkollave të vendeve të NATO-s.

Në këtë kontekst, kërkohet që procesi i arsimit dhe trajnimit individual të konsolidohet më tej, në përputhje me standardet më të përparuara të NATO-s dhe objektivi kryesor i këtij sistemi të jetë mbështetja e Forcave të Armatosura me personel profesional për përmbushjen e të gjithë spektrit të detyrave operationale, ku përparësi të mbetet përgatitja e ushtarit, nënoficerit, oficerit të trupës e shtabeve dhe civilëve të Forcave të Armatosura për të gjitha nivelet.

2. QËLLIMI

Zhvillimi i një sistemi të vetëm, të hapur, gjithëpërfshirës, të plotë, të unifikuar e të standardizuar, në përputhje me nevojat dhe kushtet e reja, për t'iu përgjigjur kërkesave e detyrimeve që shtrohen përpara një force, anëtare e NATO-s.

Objektivi parësor i sistemit të arsimit dhe trajnimit individual të jetë mbështetja me burime njerëzore të mirëarsimuara e të mirëtrajnuara ushtarakisht, aftësimi profesional i personelit në funksion të rritjes së kapaciteteve operationale, në interes të realizimit të misionit, si dhe kontributit në zgjidhjet e çështjeve të sigurisë dhe mbrojtjes në kuadër kombëtar, rajonal dhe të Aleancës.

3. AUTORITETET DHE STRUKTURAT PËRGJEGJËSE

Ministri i Mbrojtjes është autoriteti që miraton dokumentin e Konceptit të Arsimit dhe Trajnimit Individual të Personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA është autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen dhe zbatimin e Konceptit të Arsimit dhe Trajnimit Individual të Personelit. Ai nxjerr urdhra dhe udhëzime për zbatimin e këtij koncepti.

Komanda e Doktrinës dhe e Stërvitjes me strukturat e saj realizon dhe zhvillon Arsimimin dhe Trajnimin Individual të personelit të Forcave të Armatosura dhe personelit të vendeve të tjera referuar marrëveshjeve përkatëse të nënshkuara nga Ministri i Mbrojtjes. Ajo është përgjegjëse për përgatitjen institucionale të oficerëve, nënoficerëve, ushtarëve dhe civilëve, përgatitjen e drejtuesve të të gjitha niveleve, miratimin e programeve arsimore e stërvitore, që zhvillohen për kurset institucionale në njësi e reparte dhe certifikimin e personelit të kurseve

të specialiteteve që zhvillohen në njësi e reparte të Forcave të Armatosura, zhvillimin e koncepteve doktrinare, standardizimit dhe mësimëve të nxjerra.

Komandat e njësive e të reparteve marrin përgjegjësi të plotë dhe përgjigjen për zhvillimin e kurseve të specialiteteve për të gjithë kategoritë e personelit, hartimin e zbatimin e programeve mësimore dhe stërvitore në bashkëpunim me Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes (AFA, SHT Bunavi, ANO), si dhe zhvillimin e certifikimin e kurseve funksionale sipas nevojave të tyre.

4. ARSIMIMI DHE TRAJNIMI INDIVIDUAL I PERSONELIT USHTARAK


4.1. TRAJNIMI I USHTARËVE



Në Forcat e Armatosura rekrutohen ushtarë të gjithë shtetasit që kanë përfunduar arsimin e mesëm dhe të lartë.

Stërvitja e këtij personeli ka si qëllim aftësimin profesional e fizik, në interes të realizimit të misionit e të detyrave. Me stërvitje synohet dhe arrihet niveli operacional, si treguesi bazë i gatishmërisë së strukturave të Forcave të Armatosura.

Sistemi i stërvitjes së ushtarit mbështetet në dy kolona kryesore: në stërvitjen individuale (institucionale) ku strukturë përgjegjëse është Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes dhe në stërvitjen kolektive (operacionale) apo stërvitjen në njësi e reparte.



a. Stërvitja individuale, ka si qëllim të përgatitë, të formojë dhe të edukojë individë të aftë për të vepruar në fushëbetëj, postë luftimi në anije. Stërvitja individuale është procesi që përgatit ushtarët për të plotësuar rolin individual në operacion, si pjesë e një grupi, skuadre

apo ekuipazhit të një anije. Ajo përfshin Stërvitjen Individuale Bazë (SIB) dhe Stërvitjen Individuale të Avancuar (SIA), të cilat zhvillohen pa ndërprerje kohore midis tyre.

Stërvitja Individuale Bazë (SIB), ka si qëllim transformimin e të gjithë të rekrutuarve në Forcat e Armatosura, nga qytetarë-civilë në ushtarakë të disiplinuar, të motivuar e të përgatitur moralisht e fizikisht, me aftësitë bazë të luftëtarit, për të zbatuar detyrat në operacion si individ dhe në përbërje të një grupi. Stërvitja Individuale Bazë zhvillohet në Shkollën e Trupës Bunavi dhe zgjat 10 javë (3 javë kalendarike dhe 7 javë stërvitore). Në përfundim të kursit, rekruti titullohet “ushtar/detar” dhe gradohet “ushtar/detar I” dhe rekrutët që janë me arsim të lartë gradohen “ushtar/detar II”.

Stërvitja Individuale e Avancuar (SIA), ka si qëllim përgatitjen e ushtarëve aktivë profesionistë në postin e tyre luftarak sipas specialiteteve të Forcave të Armatosura, për të plotësuar detyrat e tyre individuale në përbërje të skuadrës/ekuipazhit. Stërvitja Individuale e Avancuar zhvillohet në Shkollën e Trupës Bunavi dhe në Forcën Detare (në anije) menjëherë pas përfundimit e certifikimit të SIB dhe caktimit në detyrë në njësitë e repartet e Forcave të Armatosura dhe zgjat 10 javë (stërvitore). Përfundimi i këtij kursi mundëson marrjen e gradës “ushtar/detar II” dhe vijimin e karrierës së ushtarit/detarit me stërvitjet e kompaktësimit në njësi e reparte të Forcave të Armatosura deri në “ushtar/detar IV”.

b. Stërvitja e kompaktësimit/njësimit, ka si qëllim që përmes një procesi të shumëllojshëm stërvitjeje individuale dhe kolektive, të përgatitë drejtuesit dhe efektivat me kërkesat e fushëbetejës. Zhvillohet në njësi dhe reparte të Forcave të Armatosura dhe përfshin stërvitjen individuale përforcuese (stërvitjen në postin luftarak dhe kompaktësimin/njësimin e skuadrës), si dhe stërvitjen kolektive të repartit a njësisë. Në këtë lloj stërvitjeje marrin pjesë të gjithë elementët përbërës të luftimit, të mbështetjes në luftim dhe të mbështetjes me shërbime të luftimit. Stërvitja në njësi, në thelb, konsiston në zbatimin e doktrinës në formën e taktikave, teknikave dhe procedurave në mjedise operacionale reale. Stërvitja rilidh dhe ripërtërin stërvitjen individuale të pjesëtarëve me stërvitjen e drejtuesve të saj (për ekuipazhet e anijeve të ndara sipas klasit dhe roleve luftarake).

4.2. ARSIMIMI DHE TRAJNIMI I NËNOFICERIT

Arsimimi dhe trajnimi i nënoficerit ka si qëllim përgatitjen e mëtjeshme dhe konsolidimin e vazhdueshëm të tyre profesionalisht dhe krijimin e piramidës paralele të hierarkisë, si një kontingjent i rëndësishëm që në mënyrë të dukshme ndikon në rritjen e nivelit operacional dhe stërvitor të Forcave të Armatosura. Arsimimi dhe trajnimi i përgatit nënoficerët të drejtojnë dhe stërvitin ushtarë, grupe ushtarësh dhe nënoficerët vartës, të cilët punojnë apo luftojnë nën drejtimin e tyre. Ky sistem jep drejtim lidhësi dhe teknik dhe aftësi për të siguruar që nënoficerët të jenë të përgatitur për kryerjen e detyrës funksionale dhe atë të specialitetit për arritjen e suksesit në emërimin e radhës, në nivele më të larta përgjegjësie.

Arsimimi i nënoficerit realizohet nëpërmjet kurseve në Akademinë e Nënoficerëve (ANO) dhe njësi e reparte, të përcaktuara me kohëzgjatje: Kursi Fillestar 5 javë në ANO; Kursi Bazë, faza e parë 12 javë në ANO, faza e dytë 12 javë në njësi e reparte; Kursi i Avancuar, faza e parë 8 javë në ANO, faza e dytë 8 javë në njësi e reparte, Kursi i Lartë 8 javë dhe Kursi i Kryekapitullit 4 javë në Akademinë e Nënoficerëve.



4.2.1 Rekrutimi i nënoficerit: Burimi i rekrutimit do të jetë Ushtar IV (Detar IV).



4.2.2 Kursi Fillestar i Nënoficerit (KFNO). Kursi ka si qëllim hedhjen e bazave për karrierën e nënoficerit, ofrimin e njohurive teoriko-praktike për drejtimin e grupit dhe niveleve të njësuara me të, si dhe shkëputjen nga përgjegjësia individuale në aftësi e përgjegjësi si drejtues. Në këtë kurs marrin pjesë ushtarakët me gradën “ushtar/detar IV”. Ai zhvillohet në Akademinë e Nënoficerëve “Thomson” dhe zgjat 5 javë. Përfundimi i këtij kursi mundëson titullimin "**nënoficer aktiv**" dhe gradimin "**nëntetar**".

4.2.3 Kursi Bazë i Nënoficerit (KBNO). Kursi ka si qëllim përgatitjen e drejtuesve në rol të komandantit të skuadrës në specialitetin përkatës. Në këtë kurs marrin pjesë nënoficerë me gradën “nëntetar”. Kursi zhvillohet në dy pjesë:

Pjesa e parë (leadershipi) ka si qëllim zhvillimin e elementeve themelore të personalitetit të Tetarit si drejtues në rol të komandantit të skuadrës dhe detyra të njehsuara me të, edukimin dhe përgjegjësinë ndaj detyrës dhe gatishmërisë luftarake, në zbatimin e urdhrave dhe forcimin e disiplinës vetjake. Zhvillohet në Akademinë e Nënoficerëve “Thomson” dhe zgjat 12 javë.

Pjesa e dytë (specialitet) ka si qëllim përgatitjen me njohuri teorike, teknike, menaxhuese në një nga specialitetet ushtarake, me aftësi bazë drejtuese për komandimin e skuadrës në operacione. Zhvillohet në njësitë dhe repartet e FA-ve dhe zgjat 12 javë.

Përfundimi i këtij kursi mundëson marrjen e gradës “**Tetar**”.

4.2.4 Kursi i Avancuar i Nënoficerit (KANO). Kursi ka si qëllim përgatitjen e nënoficerit në rolin e zëvendëskomandantit të togës në specialitetin përkatës. Në këtë kurs marrin pjesë nënoficerë me gradën “tetar”. Ky kurs zhvillohet në dy pjesë:

Pjesa e parë (leadershipi) ka si qëllim zhvillimin e elementeve themelore të personalitetit të Rreshterit si drejtues në rol të zv.komandantit të togës dhe detyra të njehsuara me të, zotërues i teknikave të punës dhe ndihmës kryesor për stërvitjen e togës, si dhe zhvillimin e aftësive komunikuese dhe drejtuese. Zhvillohet në Akademinë e Nënoficerëve “Thomson” dhe zgjat 8 javë.

Pjesa e dytë (specialitet) ka si qëllim përgatitjen e tetarëve me njohuri teorike, teknike, menaxhuese në specialitetin përkatës ushtarak, si dhe jep aftësi bazë drejtuese në rol të zëvendëskomandantit të togës ose detyra të njehsuara me të. Zhvillohet në njësitë dhe repartet e Forcave të Armatosura dhe zgjat 8 javë.

Përfundimi i këtij kursi mundëson marrjen e gradës “**Rreshter**”.

4.2.5 Kursi i Lartë i Nënoficerit (KLNO). Kursi ka si qëllim zhvillimin e elementeve themelore të personalitetit të Kapterit, si këshilltar i komandantit të nënrepartit dhe repartit dhe detyra të njehsuara me të. Në këtë kurs marrin pjesë nënoficerë me gradën “rreshter”. Zhvillohet në Akademinë e Nënoficerëve “Thomson” dhe zgjat 8 javë. Përfundimi i këtij kursi mundëson marrjen e gradës “**Kapter**”.


4.2.6 Kursi i Kryekapterit (KKK). Kursi ka si qëllim zhvillimin e elementeve themelore të personalitetit të Kryekapterit, si këshilltar i komandantit të forcës dhe njësisë dhe detyra të njehsuara me të. Në këtë kurs marrin pjesë nënoficerë me gradën “Kapter”. Zhvillohet në Akademinë e Nënoficerëve “Thomson” dhe zgjat 4 javë. Përfundimi i këtij kursi mundëson marrjen e gradës “**Kryekapter**”.

5. ARSIMIMI DHE KUALIFIKIMI I OFICERËVE

Rekrutimi i kandidatëve për oficerë në FA do të jetë i larmishëm. Në bazë të legjislacionin në fuqi burimet e rekrutimit do të jenë:

a) Shtetasit shqiptarë që kanë kryer arsimin parauniversitar brenda ose jashtë vendit. Kjo kategori do të rekrutohen kryesisht për ndjekjen e studimeve në Akademitë Ushtarake të vendeve të NATO-s, në bazë të marrëveshjeve të bashkëpunimit dypalësh në fushën e arsimimit ushtarak.

b) Shtetasit shqiptarë që kanë kryer arsimin e lartë (minimumi *Bachelor*), brenda ose jashtë vendit, të njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë. Ky burim është i hapur edhe për ushtarët/detarët dhe nënoficerët aktivë të Forcave të Armatosura, të cilët kanë kryer arsimin e lartë dhe kanë demonstruar devocion, ndershmëri, kurajë, përkushtim dhe aftësi të larta profesionale në shërbimin aktiv. Ata do të kryejnë kursin përkatës ushtarak për t'u përgatitur si oficerë.



5.1 Kursi i Përgatitjes të Oficerit të Ri (KPO). Pas rekrutimit nga Qendra e Personel-Rekrutimit, kandidati për oficerë do ta zhvillojë programin e arsimimit të plotë pa ndërprerje në Akademinë e Forcave të Armatosura. Ky program do të zhvillohet në një vit akademik, i ndarë në dy faza:

Faza e parë, Stërvitja Individuale Bazë e Oficerit të Ri, ka si qëllim transformimin e të gjithë të rekrutuarve për oficerë në Forcat e Armatosura, nga qytetarë-civilë në ushtarakë të disiplinuar, të motivuar e të përgatitur moralisht e fizikisht. Zhvillohet nga Akademia e Forcave të Armatosura dhe zgjat 10 javë.


Faza e dytë, Arsimimi i përgjithshëm i Oficerit të Ri, ka si qëllim të edukojë, trajnojë dhe frymëzojë kandidatët që përgatiten për oficer në nivelin e komandantit të togës për të qenë

liderë me karakter, intelektualisht, profesionalisht dhe fizikisht të aftë për të shërbyer dhe drejtuar në Forcat e Armatosura. Zhvillohet në Akademinë e Forcave të Armatosura dhe zgjat 27 javë.

Përfundimi i Kursit të Përgatitjes të Oficerit të Ri mundëson titullimin "Oficer aktiv" dhe marrjen e gradës "Nëntoger".

Ky kurs ofron mundësinë e ndjekjes së programit të ciklit të dytë të studimeve "Master Profesional" në fushën e mbrojtjes.

5.2 Kursi Bazë i Oficerit (KBO). Kursi ka si qëllim përgatitjen e kandidatëve për oficer me njohuri teorike, teknike, menaxhuese në një nga specialitetet ushtarake, me aftësi bazë taktike dhe drejtuese për komandimin e togës në operacione, si dhe të japë njohuri për drejtimin e kompanisë. Në këtë kurs marrin pjesë oficerët me gradën "Nëntoger". Kursi zhvillohet në njësi dhe reparte të Forcave të Armatosura, me kohëzgjatje 12 deri 24 javë. Për specialitetet "Detar" dhe "Specialist furnizimi" kohëzgjatja e kursit është 24 javë, ndërsa për specialitetin "Teknik helikopteri", kohëzgjatja e kursit është 30 javë. Përfundimi i këtij kurs mundëson marrjen e gradës "Toger"/ "Lejtënant".



5.3 Kursi i Avancuar i Oficerit (KAO). Kursi ka si qëllim të thellojë aftësitë, njohuritë teorike, teknike e menaxhuese në specialitetin ushtarak përkatës të togerëve/lejtënantëve, përgatitjen e tyre me aftësi bazë taktike dhe drejtuese për komandimin e kompanisë në operacione të ndryshme luftarake dhe joluftarake, si dhe të japë njohuri për batalionin. Në këtë kurs marrin pjesë oficerët që kanë gradën "Toger"/ "Lejtënant", pas 2 vite kohë qëndrimi në këtë gradë. Zhvillohet pranë njërive dhe reparteve të Forcave të Armatosura, me kohëzgjatje 12 javë. Përfundimi i këtij kurs mundëson marrjen e gradës "Kapiten"/ "Kapiten Lejtënant".

5.4 Kursi Themelor i Oficerit të Shtabit (KTHOSH). Kursi ka si qëllim përgatitjen e oficerit të shtabit të batalionit (ose ekuivalente), dhënien e njohurive në nivelin e Brigadës, si dhe përzgjedhjen e oficerëve më të mirë për të vijuar karrierën si oficerë profesionistë. Në këtë kurs marrin pjesë të gjithë oficerët e specialiteteve të Forcës Tokësore, Detare dhe Ajrore, pas 2 vite kohë qëndrimi në gradën "Kapiten"/ "Kapiten Lejtënant". Zhvillohet në Akademinë e Forcave të Armatosura dhe zgjat 14 javë. Përfundimi i këtij kurs mundëson marrjen e gradës "Major"/ "Kapiten i Rangut të III".

5.5 Kursi i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKSHP). Kursi ka si qëllim përgatitjen e oficerit të karrierës për të plotësuar detyra në nivel komandant batalioni dhe shtab brigade (ose ekuivalente) /force dhe jep njohuri për nivelin operativo-strategjik. Në këtë kurs marrin pjesë të gjithë oficerët e specialiteteve të Forcës Tokësore, Detare dhe Ajrore që kanë gradën “Major”/ “Kapiten i Rangut të III”, pas 3 vite kohë qëndrimi në këtë gradë. Zhvillohet në Akademinë e Forcave të Armatosura dhe zgjat një vit akademik. Përfundimi i këtij kursi mundëson marrjen e gradës “Nënkolonel”/ “Kapiten i Rangut të II”.

Ky kurs ofron mundësinë e ndjekjes së programit të ciklit të dytë të studimeve “Master Shkencor” në fushën e sigurisë.

5.6 Kursi i Lartë i Oficerit (KLO). Kursi ka si qëllim përgatitjen e oficerit të karrierës për të plotësuar detyra në nivel operativo-strategjik. Në këtë kurs marrin pjesë të gjithë oficerët e specialiteteve të Forcës Tokësore, Detare dhe Ajrore që kanë gradën “Nënkolonel”/ “Kapiten i Rangut të II”, pas 2 vite kohë qëndrimi në këtë gradë. Zhvillohet në Akademinë e Forcave të Armatosura dhe zgjat një vit akademik. Përfundimi i këtij kursi mundëson marrjen e gradës “Kolonel”/ “Kapiten i Rangut të I”.

Ky kurs ofron mundësinë e ndjekjes së programit të ciklin e tretë të studimeve “Master ekzekutiv” në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes.

5.7 Kursi i Lartë i Sigurisë dhe i Mbrojtjes (KLSM), ka si qëllim aftësimin e ushtarakëve dhe civilëve të niveleve strategjike në Ministrinë e Mbrojtjes, Forcat e Armatosura dhe institucionet e tjera të sigurisë së vendit dhe atyre analoge të vendeve të tjera. Zhvillohet në AFA në një periudhë prej 3 (tre) muaj. Programi i këtij kursi jep njohuri dhe trajnim analitik për probleme të mbrojtjes dhe të sigurisë, në nivelin kombëtar, rajonal e më gjerë. Kursi kryhet në gjuhën angleze. Për ushtarakët e karrierës është kusht për marrjen e gradës “Gjeneral Brigade” / “Kundëradmiral”.

5.8 Kurse dhe seminare të tjera. Krahas kurseve institucionale për zhvillimin e karrierës së oficerëve, Akademia e Forcave të Armatosura ofron programe dhe organizon kurse dhe seminare sipas nevojave të Forcave të Armatosura. Në këto kurse mundësohet trajnimi i kontingjenteve ushtarake dhe civilë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që janë përzgjedhur për të shërbyer në misione dhe përfaqësitë jashtë vendit.

5.9 Kurse funksionale (On job training) kanë si qëllim aftësimin e personelit ushtarak dhe civil në kryerjen e detyrës funksionale për nevoja informuese dhe familjarizuese me standarde e procedura të reja të NATO, armatime apo sisteme të reja modernizimi, si dhe aftësimin e personelit ushtarak dhe civil që merr pjesë në operacionet e drejtuara nga NATO/OKB/BE etj. Këto kurse do të zhvillohen dhe certifikohen nga komandat e njësive, reparteve dhe drejtuesit e shërbimeve.

5.10 Studime të thelluara në ciklin e dytë në fushën e mbrojtjes.

Akademia e Forcave të Armatosura, si institucion i Arsimit të Lartë Publik, zhvillon programet e Kursit të Përgatitjes së Oficerit të Ri (KPO) dhe Kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKSHP), të cilat ofrojnë mundësinë e vijimit të studimit në programe të ciklit të dytë, përkatësisht “Master profesional” në fushën e mbrojtjes për KPO dhe “Master shkencor” në fushën e sigurisë për KKSHP.

5.11 Studime të thelluara në ciklin e tretë në fushën e sigurisë e të mbrojtjes.

Programet e studimit për ciklin e tretë “Master ekzekutiv” dhe “Doktoraturë” në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes synojnë zgjidhjen dhe dhënien e kontributeve në këtë fushë nga personeli ushtarak e civil sipas nevojave të Forcave të Armatosura.

Kursi i Lartë i Oficerit (KLO) ofron mundësinë e vijimit të studimit në programin e ciklit të tretë, përkatësisht “Master ekzekutiv” në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Programi i studimit për “Doktoraturë” në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes të mundësohet nga Akademia e Forcave të Armatosura, nëpërmjet bashkëpunimit me të tretët (institucionet e tjera të Arsimit të Lartë të RSH), bazuar në nevojat e Forcave të Armatosura, të miratuara nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe Ministri i Mbrojtjes.

5.12 Kurset dhe kualifikimet ushtarake jashtë vendit. Shkollat dhe kurset e trajnimit në vendet partnere zhvillohen mbi bazën e planit të bashkëpunimit që ka Forca e Armatosur e Republikës së Shqipërisë me këto vende. Personeli ushtarak për ndjekjen e këtyre kurseve përzgjidhet sipas kritereve të përcaktuara me akte të veçanta.

6. PROGRAMET E ZHVILLIMIT TË GJUHËS SË HUAJ

Qendra e Gjuhëve të Huaja, në Akademinë e Forcave të Armatosura, është institucioni i vetëm i autorizuar për zhvillimin e programeve, procedurave, standardeve të testimit dhe certifikimin e personelit në Forcat e Armatosura.

Qëllimi i trajnimit në gjuhën e huaj është mbikëqyrja e kualifikimeve institucionale brenda dhe jashtë vendit, zhvillimi i karrierës, si edhe pjesëmarrja në misione të ndryshme jashtë vendit.

Mbështetur në Politikën e Arsimit për Programin e Gjuhës së Huaj, trajnimi i personelit të FA në gjuhën angleze, të bëhet sipas STANAG-ut 6001.

Zhvillimi i kurseve intensive të gjuhës angleze për nivelin 2/2/2/2, 3/2/3/2 dhe 3/3/3/3/ të bëhet në QGJH, ndërsa për nivelet 1/0/1/0, 1/1/1/1 dhe 2/1/2/1 të bëhet në njësitë e repartet parësore të FA, duke angazhuar në rolin e instruktorit të gjuhës, oficerët dhe nënoficerët e trajnuar për këtë qëllim.

Testimet për përcaktimin e shkallës së njohurive të Gjuhës së Huaj të bëhen në bazë të procedurave të “STANAG”-ut 6001 dhe ALCPT. Pasqyrimi i të dhënave në *database* të bëhet pas çdo faze testi dhe ato të jenë të vlefshme për çdo kualifikim, gradim, trajnim, aktivitet brenda dhe jashtë vendit etj.

6.1 Kurset afatshkurtra për trajnimin e personelit për terminologjinë operacionale të bëhen kryesisht për personelin që shkon në operacione jashtë vendit, me qëllim rifreskimin dhe ruajtjen e nivelit gjuhësor në bazë të nevojave të Forcave të Armatosura.

Referencat:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Strategjia e Sigurisë e Republikës së Shqipërisë, (korrik 2014).
- Strategjia Ushtarake e FA të RSH, 2007, (Ligji nr 72/2015 për miratimin e SU).
- Dokumenti i Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes, 2013.
- Direktiva e Ministrit të Mbrojtjes 2017.
- Doktrina Ushtarake FARSH (DP-01), 2013, miratuar me urdhër të SHSHP të FA nr.240 datë 13.06.2013.
- Ligji nr. 64/26.06.2014, datë 26. 06. 2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të RSH”.
- Ligji nr. 59, datë 12.06.2014 “Për karrierën ushtarake në FARSH”.
- Plani Afatgjatë i Zhvillimit të FA 2016–2025, (ligji nr.121/2015).
- Ligji nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.
- Raporti i parë i Komisionit Qeveritar për Arsimin e Lartë (28.04.2014).
- Raporti i konsorciumit të akademive dhe dokumenteve alternative që mund të ofrojë CUBIC.
- BI-SC 75-2 Education and Training Directive, 2014.
- BI-SC 75-7 Education and Individual Training Directive, 2014.
- Doktrina e Arsimimit dhe Stërvitjes në FARSH MP 3-4, Tiranë 2009.
- Koncepti i Arsimimit UP, miratuar me urdhër të MM nr.1206 datë 10.09.2014.
- Urdhri i MM, nr.2253, dt.31.12.2012,“Politika e arsimimit dhe trajnimit individual të personelit të FA të RSH”.
- Urdhri i MM, nr.2196 datë, 22.12.2014, për “Politikat dhe procedurat e rekrutimit të kandidatëve për oficerë të rinj në FA”.
- Vendimi i Agjencisë së Akreditimit, nr. 90, dt. 03.09.2010.